



MINI ME MANUALI I PËRDORIMIT



TABELA E PËRMBAJTJES

MASAT E SIGURISË	3-4
PËRMBLEDHJE	5
LLOJET E PRODUKTEVE	6-7
HERA E PARË E PËRDORIMIT	8
PËRGATITJA E PIJES	9
REKOMANDIME PËR NJË PËRDORIM TË SIGURT / MËNYRA EKONOMIKE	10
PASTRIMI	11
NËSE NGA MAKINA NUK DEL LËNG... ..	12-13
KRYENI PROCESIN E DEKALÇIFIKIMIT TË PAKTËN ÇDO 3-4 MUAJ	14-15
ZGJIDHJE PËR PROBLEMET	16-17

Gjatë përdorimit të aparateve elektrike, masat themelore paraprase të sigurisë duhet të respektohen, përfshirë edhe këto në vijim:

1. Lexoni të gjitha udhëzimet e sigurisë dhe ruajini ato.
2. Lidheni pajisjen në prizën e korrentit vetëm me një lidhje tokëzimi. Tensioni i rrjetit duhet të jetë i njëjtë me detajet në pllakëzën e të dhënave. Përdorimi i lidhjeve të pasakta do të bëjë të pavlefshme garancinë dhe mund të jetë i rrezikshëm.
3. Ky aparat është i destinuar të përdoret vetëm në kushtet e shtëpisë. Nuk është i destinuar të përdoret në aplikimet në vijim, dhe garancia nuk do të zbatohet për:
 - zonat e personelit të kuzhinës në dyqane, zyra dhe mjedise të tjera të punës;
 - ambientet e agriturizmit;
 - nga klientët në hotele, motele dhe mjedise të tjera banimi rezidenciale;
 - mjedise të tipit hostel që përfshijnë mëngjesin dhe fjetjen (bed and breakfast);
4. Pajisja juaj është caktuar për përdorim të brendshëm në shtëpi në një lartësi vetëm nën 3400 m.
5. Në rast të një përdorimi të papërshtatshëm apo mospajtimi me udhëzimet, prodhuesi nuk mban asnjë përgjegjësi dhe garancia nuk mund të zbatohet.
6. Ju rekomandojmë përdorimin e kapsulave NESCAFÉ® Dolce Gusto® projektuar dhe testuar për makinerinë NESCAFÉ® Dolce Gusto®. Ato janë projektuar të ndërveprojnë bashkarish - ndërveprimi siguron cilësinë brenda filxhanit për të cilën NESCAFÉ® Dolce Gusto® është e njohur. Çdo kapsulë është e projektuar të përgatisë një filxhan të shkëlqyer kafje dhe nuk mund të përdoret sërish.
7. Mos i hiqni kapsulat e nxehta me dorë. Përdorni doreza ose xhunga.
8. Gjithmonë përdoreni aparatën në një sipërfaqe të rrafshët, të qëndrueshme, rezistente karshi nxehtësie dhe larg burimeve të nxehtësisë ose spërkatjeve të ujit.
9. Për ta mbrojtur karshi, goditjeve të energjisë elektrike, zjarrit apo lëndimit të personave mos e zhytni kordonin e energjisë elektrike, spinën ose dhe vetë aparatën në ujë apo lëng tjetër. Asnjëherë mos prekni kordonin me duar të lagura. Mos e tejmbushni rezervuarin e ujit.
10. Në rast emergjence stakoni menjëherë spinën nga priza e korrentit.
11. Kur aparatë përdoret në afërsi të fëmijëve është e nevojshme një mbikëqyrje e afërt dhe e kujdesshme. Mbajeni aparatën / kordonin e energjisë / mbajtësin e kapsulës larg fëmijëve. Fëmijët duhet të mbikëqyren për t'u siguruar që të mos luajnë me pajisjen. Mos e braktisni asnjëherë aparatën, ndërsa jeni duke bërë një piqe.
12. Ky aparat nuk është i destinuar për përdorim nga persona apo fëmijë, me aftësi të reduktuara fizike, ndijore apo mendore, ose me mungesën e përvojës dhe të njohurive, vetëm nëse atyre iu është dhënë mbikëqyrje apo udhëzime lidhur me përdorimin e aparatit nga një person përgjegjës për sigurinë e tyre. Personat që kanë një njohje të kufizuar ose aspak njohje të funksionimit dhe përdorimit të këtij aparatë duhet të s'pari të lexojnë dhe të kuptojnë plotësisht përmbajtjen e këtij doracak (manuali) përdorimi, dhe kur është e nevojshme të kërkojnë udhëzime shtesë për funksionimin dhe përdorimin e tij nga personi përgjegjës për sigurinë e tyre.
13. Mos e përdorni pajisjen pa kutinë mbledhëse dhe skarën për lëngun që pikon, përveçse në rastet kur përdoret një gotë (krikëll) shumë e gjatë Mos e përdorni aparatën për përgatitjen e ujit të ngrohtë.
14. Për arsye shëndetësore, gjithmonë mbushni depozitën e ujit me ujë çezme të freskët.
15. Pas përdorimit të aparatit gjithmonë largoni kapsulën dhe pastroni mbajtësin e kapsulës. Zbrazi dhe pastroni kutinë mbledhëse dhe koshin e kapsulës çdo ditë. Për përdoruesit alergjikë ndaj prodhimeve të qumështit: Shpëlani kokën sipas procedurës së pastrimit.
16. Stakojeni nga priza kur aparatë nuk është në përdorim.
17. Stakojeni nga priza përpara pastrimit. Lëni të ftohet para se të vendosni pjesët përbërëse në të ose para se t'i hiqni ato, para pastrimit të aparatit. Asnjëherë mos pastroni/me të lagësht ose të zhytni, aparatën në ndonjë lëng. Kurrë mos e pastroni aparatën me ujë të rrjedhshëm. Asnjëherë mos përdorni detergjentë për të pastruar aparatën. Pastroni aparatën vetëm duke përdorur sfungjerë / furça të buta. Depozita e ujit duhet të pastrohet me një furçë për shishe fëmijësh.
18. Asnjëherë mos e ktheni mbrapsht makinën.
19. Në qoftë se largoheni për periudha të gjata, me pushime, etj aparatë duhet të jetë i zbrazur, i pastruar dhe i shkëputur nga korrenti. Shpëlajeni përpara ripërdorimit. Vini në funksionim ciklin e shpëlarjes përpara ri-përdorimit të aparatit tuaj.
20. Mos e fikni aparatën gjatë procesit të dekalçifikimit. Shpëlani depozitën e ujit dhe pastroni makinën për të shmangur ndonjë agjent të mbetur të dekalçifikimit.

21. Çdo veprim, që nënkupton pastrimin dhe kujdesin përtej përdorimit normal duhet të ndërmerret nga qendrat e shërbimit të post-shitjes të miratuara nga linja telefonike NESCAFÉ® Dolce Gusto®. Mos e çmontoni pajisjen dhe mos vini asgjë në pjesën e hapjeve.
 22. Në rast përdorimi intensiv pa mundësuar kohën e mjaftueshme të ftohjes, aparati do të ndalë për kohësisht funksionimin me treguesin vibruës të dritës së kuqe. Kjo bëhet për të mbrojtur pajisjen tuaj nga mbinxehja. Shuaqjeni aparatin për 20 minuta për ta lënë ftohet.
 23. Mos e vini në përdorim aparatin nëse kablloja apo spina është e dëmtuar. Nëse kordoni i furnizimit me korrent është dëmtuar, ai duhet të zëvendësohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të kualifikuar të kësaj kategorie, në mënyrë që të shmangët rreziku. Mos përdorni aparatin, nëse nuk funksionon siç duhet ose në qoftë se ka prova të dëmtimit. Hiqeni menjëherë kordonin nga priza. Ktheni aparatin e dëmtuar në objektin më të afërt të autorizuar të shërbimit të miratuar nga NESCAFÉ® Dolce Gusto® Hotline.
 24. Përdorimi i pajisjeve ndihmëse të cilat nuk janë rekomanduar nga fabrikuesi i aparatit mund të çojnë në zjarr, goditje elektrike ose plagosje personi.
 25. Mos e vendosni kordonin e korrentit në afërsi të burimeve të ngrohjes, skajeve të mprehta, etj.
Mos e lejonit të varet kordonin e prizës (rrezik lëndimi). Asnjëherë mos prekni kordonin me duar të lagura.
 26. Mos e vendosni aparatin mbi apo pranë një sobe të nxehtë elektrike apo me gaz ose në një mikrovalë të ndezur.
 27. Për ta shkëputur, shtypni butonin OFF të energjisë dhe më pas, hiqni spinën nga priza e murit. Mos e stakoni nga priza duke tërhequr kordonin.
 28. Gjithmonë mbyllni kokën e ekstraktimit me mbajtësin e kapsulës. Mos e hiqni mbajtësin e kapsulës deri në momentin që indikatorit të ndërprësë ndriçimin pulsues. Aparati nuk do të funksionojë në qoftë se mbajtësi i kapsulës nuk është i futur.
 29. Mund të përvëloheni nga lëngu nëse leva është e hapur gjatë cikleve të përgatitjes së pijes. Mos e ngrini levën para se ndriçimi në pjesën qendrore të makinës të ndalojë daljen e dritës.
 30. Mos vini gishtat në prizë gjatë përgatitjes së pijes.
 31. Mos e prekni gjilpërën e pjesës së kokës.
 32. Asnjëherë mos mbani aparatin nga koka e ekstraktimit.
 33. Mbajtësi i kapsulës është i pajisur me magnetë të përhershme. Shmangni vendosjen e mbajtësit të kapsulës pranë aparateve dhe objekteve që mund të dëmtohen nga magnetizmi, p.sh. karta krediti, disqe dhe pajisje të tjera të dhënash, kaseta video, televizioni dhe monitorë kompjuteri me tuba katodikë, orë mekanike, aparate dëgjimi dhe autoparlantë zanorë. Pacientët me stimulues kardiakë ose defibrilatorë: Mos e mbani mbajtësin e kapsulës direkt mbi një stimulues kardiak ose defibrilator.
 34. Mundësohet një kablo e shkurtër e furnizimit me energji për të zvogëluar rreziqet që rezultojnë nga ngatërrimi ose nga pengimi dhe rrëzimi mbi një kablo më të gjatë Kordonë zgjatues më të gjatë, mund të përdoren nëse ushtrohet kujdes në përdorimin e tyre.
 35. Në qoftë se priza e korrentit nuk përputhet me spinën në aparatit, zëvendësoni spinën e pajisjes me llojin e përshtatshëm në qendrat e shërbimit të post-shitjes të miratuara nga NESCAFÉ® Dolce Gusto® Hotline.
 36. Paketimi është realizuar nga materiale të riciklueshme. Kontaktoni autoritetin/ këshillin tuaj lokal për informacione të mëtejshme mbi riciklimin. Aparati juaj përmban materiale të vlefshme të cilat mund të rikuperohen apo riciklohen.
 37. Për udhëzime të mëtejshme për mënyrën e përdorimit të pajisjes, referojuni manualit (doracakut) të përdoruesit në www.dolce-gusto.com ose telefononi në numrin e linjës telefonike të NESCAFÉ® Dolce Gusto®.
- ### VETEM PËR TREGJET EUROPIANE:
38. Mbajeni aparatin dhe kordonin e saj më larg duarve të fëmijëve në moshë më të vogël se 8 vjeç. Fëmijët nuk duhet të luajnë me aparatin.
 39. Ky aparat mund të përdoret nga fëmijë në moshë prej 8 vjeç e më lartë dhe persona me aftësi të zvogëluar, fizike, ndijore dhe mentale ose mungesë të përvojës dhe njohurisë nëse janë nën vëzhgim ose kanë marrë udhëzime për përdorimit të aparatit në mënyrë të sigurt dhe i kuptojnë rreziqet me të cilat mund të përballohen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhet të bëhet nga fëmijë përveç nëse janë mbi moshën 8 vjeçe dhe janë nën vëzhgim.
- Kjo pajisje është emërtuar në përputhje me Direktivën Europiane 2002/96/EC në lidhje me pajisjet e përdorura elektrike dhe elektronike - EEEE). Direktiva përcakton kuadrin për rikthimin dhe riciklimin e pajisjeve të përdorura si të aplikueshme në të gjithë BE-në.
- Duhet të jeni të vetëdijshëm se aparati ende përdor energji elektrike ndërsa është në modalitetin ekologjik (0,4 W/orë).

PËRMBLEDHJE




- | | | | |
|-----------------------|----------------------------------|-----------------------|--|
| ① Depozita e Ujit | ④ Stop | ⑦ Doreza Mbyllëse | ⑩ Rrjeta (skara) për mbledhjen e lëngut pikues |
| ② Leva e Përzgjedhëse | ⑤ E nxehtë | ⑧ Mbajtësi i kapsulës | ⑪ Tabakaja për mbledhjen e lëngut pikues |
| ③ E Ftohtë | ⑥ Zgjedhësi i nivelit të dozimit | ⑨ Butoni i energjisë | |

~	CZ, SK, HZ, BS, BG, RO, PL, LT, SL, AL, HR, MK, ME, KS, LV, EE	230 V/220 B	50 Hz/50 Гц	max./máx./maks. 1500 W/макс. 1500 Вт
---	--	-------------	-------------	--------------------------------------


P	max. 15 bar	0.8 l	kg	~2.5 kg	5-45 °C 41-113 °F	A = 16 cm B = 30.5 cm C = 24 cm
---	-------------	-------	----	---------	----------------------	---------------------------------------





LLOJET E PRODUKTEVE




Pije të ngrohta



ESPRESSO




35 ml
Ristretto





50 ml
Espresso
Espresso Intenso

LUNGO



120 ml

CAPPUCCINO



200 ml




40 ml



240 ml

CHOCOCINO



100 ml



110 ml




210 ml


LLOJET E PRODUKTEVE



LATTE MACCHIATO




CHAI TEA LATTE



Pije të ftohta




CAPPUCCINO ICE




HERA E PARË E PËRDORIMIT




Shpëlani më parë me ujë depozitën e ujit. Mbusheni depozitën me ujë të freskët, të pijshëm dhe vendoseni depozitën mbrapa në makinë.




Hapni dorëzën përmblyëse dhe futni mbajtësin e zbrazët të kapsulës. Mbyllni dorëzën përmblyëse. Vendosni një enë për ujë me kapacitet 1 litër nga poshtë.




Sigurohuni që leva përzgjedhëse të jetë në pozicionin "STOP". Më pas lidhni kyçësen e rrymës me prizën e rrjetit.




Vini makinën në Përdorim. Butoni i energjisë fillon të pulsojë me ngjyrë të kuqe ndërsa makina po ngrohet për 30 sekonda me përafërsi. Më pas, butoni i energjisë lëshon një dritë konstante me ngjyrë jeshile dhe makina është gati.



Vendoseni levën në nivelin maksimal të vijëzave. Lëvizni levën majtas/djathtas për të filluar me shpëlarjen.



Pritni deri sa leva të kthehet në mes dhe të ndalojë rrjedhja. Makina ndalon ciklin e shpëlarjes dhe butoni i energjisë pulson me dritë të kuqe për rreth 10 sekonda.



Lëvizni levën majtas/djathtas për të filluar me shpëlarjen.




Pritni deri sa leva të kthehet në mes dhe të ndalojë rrjedhja. Zbrazeni dhe pastrojeni enën. Mbusheni depozitën për ujë me ujë të pijshëm të freskët deri në maksimale.



Vendosni skarën pikuese mbi tabakanë e përdorur për lëngun që pikon. Më pas, futni tabakanë për mbledhjen e lëngut pikues në pozicionin e dëshiruar e makinës.


PËRGATITJA E PIJES



Vini Makinën në përdorim. Butoni i energjisë fillon të pulsojë me ngjyrë të kuqe ndërsa makina po ngrohet për 30 sekonda me përafërsi. Më pas, butoni i energjisë lëshon një dritë konstante me ngjyrë jeshile dhe makina është gati.




Fiksni pozicionin e tabakasë që mbledh lëngun pikues në përputhje me pijen e zgjedhur (shihni faqen 6-7). Vendosni filxhanin në tabakanë që mbledh lëngun pikues.




Hapni dorezën mbyllëse dhe largoni mbajtësin e kapsulës. Vendosni kapsulën në mbajtësin e kapsulës dhe futeni atë në makinë. Mbyllni dorezën përmbyllëse.



Vendosni nivelin e dozimit të pijes me anë të zgjedhësit sipas udhëzimeve në kapsulën ose përshtateni sipas shijes së juaj personale.




Lëvizni levën në të djathtë për pije të ngrohtë ndërsa në të majtë për pije të ftohtë. Menjëherë, fillon përgatitja e pijes. Pritni deri sa leva të kthehet në mes dhe të ndalojë rrjedhja. Rrjedhja mund të ndalohej edhe në mënyrë manuale duke e lëvizur levën në pozitën e mesme.



Pas mbarimit të përgatitjes butoni i energjisë pulson me dritë të kuqe për rreth 10 sekonda. **Gjatë kësaj kohe mos e hapni dorezën mbyllëse!**



Merrni filxhanin nga tabakaja që mbledh lëngun pikues. Hapni dorezën përmbyllëse.




Tërhiqni mbajtësin e kapsulës dhe largoni kapsulën e përdorur. Hidhni kapsulën.



Shpëlajeni me ujë nga të dyja anët dhe lëreni të thatet mbajtësin e kapsulës. Futni mbajtësin e kapsulës brenda në makinë. Ju bëftë mirë!



REKOMANDIME PËR NJË PËRDORIM TË SIGURT



⚠ Asnjëherë mos mbushni ujë të nxehtë në depozitën e ujit!




⚠ Asnjëherë mos hapni dorezën përmblylëse gjatë përgatitjes së pijes!



⚠ Pas mbarimit të përgatitjes butoni i energjisë pulson me dritë të kuqe për rreth 10 sekonda. **Gjatë kësaj kohe mos e hapni dorezën mbylëse!**



⚠ Asnjëherë mos shtyni levën përzgjedhëse në kohën kur doreza përmblylëse është e hapur!



⚠ Mos e prekni kapsulën e përdorur pas përgatitjes së pijes! Sipërfaqja e nxehtë, rrezik djegieje!



⚠ Për pastrimin e kokës së makinës asnjëherë mos përdorni shpuzë të lagët por vetëm leckë për enë!

MËNYRA EKONOMIKE



Pas 5 minutash mospërdorimi makina mbyllet në mënyrë automatike. (Mënyra Ekonomike).



Shpëlani me ujë të pastër tabakanë për mbledhjen e lëngut pikues dhe pastrojeni atë me një furçë.




Shpëlajeni me ujë nga të dyja anët dhe lëreni të thatet mbajtësin e kapsulës. Ju gjithashtu mund ta vendosni atë në pjatlarëse (lavastovilje).




Lani dhe pastroni depozitën e ujit. Më pas mbusheni me ujë të freskët, të pijshëm dhe futeni atë në makinë. Uji i depozitës nuk mund të futenë në lavastovilje (pjatlarëse)!




Hapni dorëzën përmblyëse dhe futni mbajtësin e zbrazët të kapsulës. Uleni dorëzën përmblyëse. Vendosni një enë për ujë me kapacitet 1 litër nga poshtë.



Vini makinën në përdorim. Butoni i energjisë fillon të pulsojë me ngjyrë të kuqe ndërsa makina po ngrohet për 30 sekonda me përafërsi. Më pas, butoni i energjisë lëshon një dritë konstante me ngjyrë jeshile dhe makina është gati.



Me dorë, vendoseni levën në nivelin maksimal të vijëzave. Lëvizni levën majtas/djathtas për të filluar me shpëljarjen.



Pritni deri sa leva kthehet në pozitën e mesme dhe të ndalojë rrjedhja. Pastrojeni bokallin.




Vendosni skarën pikuese mbi tabakanë e përdorur për lëngun që pikon. Më pas, futni tabakanë për mbledhjen e lëngut pikues në pozicionin e dëshiruar e makinës. Pastrojeni makinën me një leckë të butë e të lagur. Thajeni atë më pas me një leckë të butë e të thatë.

NËSE NGA MAKINA NUK DEL LËNG...



1 Nuk del lëng dhe makina bën një zhurmë të fortë.




2 Ktheni levën përzgjedhëse në pozicionin neutral.



3 Kontrolloni nëse ka ujë në depozitën e ujit: Nëse jo, rimbushni dhe lëvizni përsëri levën në pozicionin e nxehtë / e ftohtë për të vazhduar me përgatitjen. Nëse po, vazhdoni si më poshtë:

Kontrolloni nëse doreza mbyllëse mund të ngrihet me lehtësi: JO - shihni seksionin (A) (më poshtë) / Po – shihni seksionin (B) (faqja tjetër)


A



1 Kapsula mund të jetë e bllokuar dhe nën presion.




2 Mos përdorni forcën për të ngritur dorezën përmblyëse.



3 Prisni 20 minuta për të zvogëluar presionin.



4 Më pas ngrini dorezën mbyllëse dhe hiqni mbajtësin e kapsulës.



5 Hidhni kapsulën.

NËSE NGA MAKINA NUK DEL LËNG...




B




Injektori mund të jetë bllokuar.




Ngrini dorezën përmblyëse dhe largoni mbajtësin e kapsulës.



Hidhni kapsulën.



Largoni ujin e depozitës dhe nxirrni gjilpërën e pastrimit. Mbyllni dorezën përmblyëse.



Hiq nga priza makinën. Për një akses më të mirë të injektorit anoni makinën.



Zhblokonti injektorin me gjilpërën e pastrimit.



1 Nëse pija del vetëm me pika ose nëse pija është më e ftohtë se zakonisht, makina duhet të dekalçifikohet.



2 Telefononi linjat e posaçme NESCAFÉ DOLCE GUSTO ose shkoni në ueb faqen të NESCAFÉ DOLCE GUSTO. Për numrat e Linjës së Posaçme shihni Broshurën e Masave paraprake të Sigurisë.




3 FIKNI makinën.




4 Në një bokall, përzini 0.5 litra ujë me lëndën kundër kalçifikimit. Hidhni përzjerjen për dekalçifikim në depozitën e ujit dhe futeni depozitën e ujit brenda në makinë.




5 Hapni dorëzën përmblyëse dhe futni mbajtësin e zbrazët të kapsulës. Uleni dorëzën përmblyëse. Vendosni një enë për ujë me kapacitet 1 litër nga poshtë.




6 Me dorë, vendoseni levën në nivelin maksimal të vijëzave. Shtypni dhe mbani të shtypur butonin e energjisë për të paktën 5 sekonda. Butoni i energjisë fillon të pulsojë me dritë të gjelbër dhe makina hyn në mënyrën e Dekalçifikimit.



7 Lëvizeni levën djathtas. Procesi i pastrimit zgjat rreth 2 minuta. Leva kthehet mbrapa në pozitën e mesme.



8 Lëvizeni levën në të majtë. Makinaria heq vazhdimisht smërçin. Leva kthehet mbrapa në pozitën e mesme.




9 Për një efekt më të mirë të heqësit të smërçit, makinaria hyn në një kohë pritjeje prej 2 min. Butoni i ndezjes vezullon ngjyrë jeshile gjatë kohës së pritjes.


KRYENI PROCESIN E DEKALÇIFIKIMIT TË PAKTËN ÇDO 3-4 MUAJ




Zbrazeni dhe pastrojni bokallin. Lani dhe pastroni depozitën e ujit. Më pas mbusheni me ujë të freskët, të pijshëm dhe futeni atë në makinë.



Lëvizni levën në të djathtë për të filluar shpëlarjen. Pritni deri sa leva të kthehet në pozitën e mesme dhe të ndalojë rrjedhja.



Lëvizni levën në të majtë/djathtë për të filluar shpëlarjen. Pritni deri sa leva kthehet në pozitën e mesme dhe të ndalojë rrjedhja.



Në fund të procesit të shpëlarjes, tastiera do të ndriçoj ngjyrë kuqe. Pritni deri sa aparati të fillojë normalisht të funksionojë. Fikeni aparatin.



Zbrazeni dhe pastrojni bokallin. Lani dhe pastroni depozitën e ujit. Më pas mbusheni me ujë të freskët, të pijshëm dhe futeni atë në makinë.




Vendosni skarën pikuese mbi tabakanë e përdorur për lëngun që pikon. Më pas, futni tabakanë për mbledhjen e lëngut pikues në pozicionin e dëshiruar e makinës. Pastrojni makinën me një leckë të butë e të lagur. Thajeni atë më pas me një leckë të butë e të thatë.



KËSHILLA TË RËNDËSISHME




Ndiqui udhëzimet në manualin e përdoruesit për kitin e përdorur në procesin e dekalçifikimit.



Shmangni kontaktet e lëngut të përdorur për dekalçifikim me çdo pjesë të makinës.



Mos përdorni uthull për procesin e dekalçifikimit.




Mos shtypni butonin e energjisë gjatë procesit të dekalçifikimit.

ZGJIDHJE PËR PROBLEMET



Makina nuk mund të ndizet.




1 Kontrolloni nëse kyçësi i kordonit është vendosur në mënyrën e duhur në prizën e korrentit. Nëse po kontrolloni furnizimin me energji elektrike.



2 Nëse makine akoma nuk mund të ndizet telefononi Numrat e Posaçëm të NESCAFÉ DOLCE GUSTO. Për numrat telefonike të posaçëm shihni Broshurën e Masave paraprake të Sigurisë.



Lëngu i pijes po shpërthen jashtë pikës së daljes së kafes.



1 Ndaloji përgatitjen, nxirri mbajtësin e kapsulës dhe kontrolloni kapsulën. Duhet të ketë vetëm një vrimë në kapsulë. Flakeni tutje kapsulën me më shumë se një vrimë.



2 Futni një kapsulë të re në mbajtësin e kapsulës dhe futeni atë përsëri në makinë.




Nëse pija del vetëm me pika ose nëse pija është më e ftohtë se zakonisht, makina duhet të dekalçifikohet.



1 Telefononi linjat e posaçme NESCAFÉ DOLCE GUSTO ose shkoni në ueb faqen e NESCAFÉ DOLCE GUSTO. Për numrat telefonike të posaçëm shihni Broshurën e Masave paraprake të Sigurisë.



Butoni i Energjisë pulson shpejt me dritë të kuqe.



Fikeni makinën. Kontrolloni nëse kapsula është e bllokuar (shihni faqen 12). Stakoni kyçësen e korrentit dhe prisni 20 minuta. Më pas vendosni spinën ushqyese në prizën e korrentit dhe ndizni makinën.



Nëse butoni i energjisë lëshon ende dritë të kuqe telefononi numrat e posaçëm të linjës NESCAFÉ DOLCE GUSTO. Për numrat telefonike të posaçëm shihni Broshurën e Masave paraprake të Sigurisë.



LINJAT E POSAÇME TELEFONIKE

AL	0842 640 10	HK	2179 8888	MK	0800 00 200
AR	0800-999-8100	HR	0800 600 604	MT	80074114
AT	0800 365 23 48	HU	06 40 214 200	MY	1800 88 3633
BE	0800 93217	IE	00800 6378 5385	NL	0800-3652348
BG	0 800 1 6666	IT	800365234	NO	800 80 730
BR	0800 7762233	JP	81-35651-6848	PE	80010210
BS	0800 202 42		(machines)	PL	0800 174 902
CA	1 888 809 9267		81-35651-6847	PT	800 200 153
CH	0800 86 00 85		(capsules)	RO	0 800 8 637 853
CL	800 4000 22	KO	080-234-0070	RU	8-800-700-79-79
CZ	800 135 135	KS	0842 640 10	SE	020-29 93 00
DE	0800 365 23 48	KZ	8-800-080-2880	SG	1 800 836 7009
DK	35460100	LU	8002 3183	SK	0800 135 135
EE	6 177 441	LT	8 700 55 200	SL	080 45 05
ES	900 10 21 21	LV	67508056	SR	0800 000 100
FI	0800 0 6161	ME	020 269 902	UK	0800 707 6066
FIL	898-0061	MEX	5267 3304	UKR	0 800 50 30 10
FR	0 800 97 07 80		01800 365 2348	US	1-800-745-3391
GR	800 11 68068		(Lada sin costo)		



Garancia nuk mbulon aparate që nuk punojnë ose që nuk punojnë mirë nga shkaqet që nuk janë mirëmbajtur dhe/ose keq të pastruar.